



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 024

EDUKIMI KUNDËR KORRUPSIONIT (EKK)

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë format e ndryshme të paraqitjes së korrupsionit në shoqëri, si dhe strategjitë për luftimin e tij.
- Të përfshijnë idenë e luftës kundër korrupsionit në kurrikulin e tyre mësimor.
- Të krijojnë klasa që nxisin diskutim të hapur dhe të përgjegjshëm, që i kontribuojnë vetëdijësimin të nxënësve për ndikimin e korrupsionit në pengimin e zhvillimit të shoqërive demokratike.
- Të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë përmes përdorimit të teknikave të shumëllojshme e të efektshme, të cilat ndihmojnë nxënësit në procesin e përvetësimin të njohurive për të mos rënë pre e dukurive korruptive.
- Të organizojnë aktivitete ekstra-kurrikulare me nxënës për sensibilizimin e opinionit publik.
- Të bëhen burim përvoja dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.

Përmbajtja

1. Përkufizimi dhe format e paraqitjes së korrupsionit. Shkaqet dhe pasojat e paraqitjes së tij. Strategjitë për luftimin e korrupsionit. Korrupsioni në sistemin e arsimit dhe mënyrat e luftimit të tij. Përfshirja e idesë së luftës kundër korrupsionit në kurrikulin mësimor të lëndëve të ndryshme. Studimet e rastit. Roli i mediave në luftimin e korrupsionit. Përgatitja e mësimëve model në grupe lëndore dhe prezantimi i tyre.

2. Prezantimi i rezultateve të monitorimit të pjesëmarrësve. Identifikimi i anëve pozitive të orëve të monitoruara dhe këshillat për tejkalimin e vështirësive eventuale. Veçoritë specifike të punës me të rritur. Stilet e të nxënësve të rritur (VAK, Kolbi, Gardner). Rolet e trajnerëve. Zhvillimi i një plani trajnimi. Strategjitë për menaxhimin e situatave

problemore. Këshilla praktike për trajnerë. Aktivitet për luftimin e paragjytimeve. Roli i institucioneve dhe OJQ në luftimin e korrupsionit. Përgatitja e mësimëve model dhe prezantimi i tyre para grupit.

Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë mësimdhënësit e lëndëve shoqërore të të gjitha niveleve të shkollimit, administratorët e shkollave, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve shkollore, zyrtarët e arsimit, si dhe të gjithë ata të cilët tregojnë interesim për të përfituar njohuri për edukimin kundër korrupsionit.

Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të 2 seminareve 3-ditore. Çdo seminar ka 25 orë trajnim, duke përfshirë orën e monitoruar dhe diskutimin e saj. Koha në mes të mbajtjes së dy seminareve duhet të jetë së paku një muaj. Pas seminarit të parë mësimdhënësit do monitorohen në klasat e tyre.

Programi ka gjithsej **50 orë**.

Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 90 % dhe monitorimi i orës mësimore.